



Republika e Kosovës/Republic of Kosovo



REPUBLICA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 09.08 2021			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400-	36849	

Komuna Drenas / Municipality Drenas
Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural /
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në kuadër të zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Drenasit - Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural duke u bazuar në Nenin 19 , pika 1.3 të rregullores **Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017** për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarrjes së Subvencioneve , njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojn për Projektin e poshtëshënuara :

THIRRJE PËR APLIKIM

FURNIZIMI I FERMERËVE ME PAISJE PËR KRASITJE TË PEMËVE – PENTARI

Kriteret që duhet plotësuar për aplikim :

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Drenasit ,
2. Të posedoj sipërfaqe me Pemishte Intenzive- Plantacion prej 0.05 – 0.8 ha ,
3. Të jetë i gatshëm për participim ,
4. Përparësi në kushte të barabarta kanë fermerët që nuk janë përfitues nga DBPZHR-ja, më parë, fermerët që nuk janë përfitues nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitit fiskal , fermerët të cilët jetojnë në zona malore , të rinjët , familjet që kanë persona me nevoja të veqanta.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Plotësimi i aplikacionit ,
2. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës ,
3. Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë ,
4. Numrin identifikues të fermerit (NIF) (përparsi fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike) ,
5. Deklaratë për participim nga fermeri
6. Fletën Poseduese të tokës në emër të aplikuesit , familjari të aplikuesit apo kontrata e noterizuar për sipërfaqen e marr me qera ku gjendet pemishtja.

Vërejtje

- Fermerët që posedojnë paisjet për të cilat aplikojn të njejtit fermer nuk mund të jenë përfitues
- Fermerët të cilët kanë përfituar nga DBPZHR Brenda vitit fiskal 2021 nuk mund të jenë përfitues edhe në këtë projekt,
- Të drejt aplikimi ka vetem një fermer nga një familje (nese aplikojn dy e më shumë fermer prej së njejtës familje , asnjëri nuk mund të jetë përfitues) ,
- Të dhënat e cekura nga fermeri për Pemishten duhet të përputhen në teren gjatë verifikimit nga komisioni ,
- Pemishtet duhet të jenë në territorin e Komunës së Drenasit ,
- Aplikacionet e pa kompletuara dhe të dorzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.
- Dorëzimi i aplikacioneve të bëhet në Arkiv – Komunë,

Afati i aplikimit nga data 09/08 / 2021 deri me 30/08 / 2021

Drenas 2021

 Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci